



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS  
DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË STANDARDEVE DHE ADMINISTRIMIT TË  
NDIHMËS DYTËSORE  
SEKTORI I MONITORIMIT TË OFRUESVE TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE  
DHE DYTËSORE

Nr. 2187/Prot.

Tiranë, më 02.12.2024

**NJOFTIM PUBLIK**

**“PËR NJOFTIMIN E EKZEKUTIMIT VULLNETAR TË DETYRIMIT PËR ZNJ.  
MARSELA KUME NË ZBATIM TË VENDIMIT NR. 41-2024-868 (253), DATË  
06.03.2024, GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË  
PËRGJITHSHËM KORÇË”**

**BASHKIA GJIROKASTËR**  
*Sheshi Çerçiz Topulli*

Referuar vendimit nr. (621) - 83 datë 13.06.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, ku z. Julian Kume është përfitues i Ndihmës Juridike Dytësore, referuar procesit gjyqësor me objekt *“Dhënia e ndihmës juridike dytësore dhe përjashtimi nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore*

Me Vendimin nr.41-2024-868 (253), datë 06.03.2024, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë në procesin civil me paditës z. Julian Kume dhe të paditur znj. Marsela Kume (Sula) me objekt *“1. Zgjidhjen e martesës ligjore mes palëve ndërgjyqëse pa u përcaktuar fajësia; 2. Lënien për rritje dhe edukim të fëmijës së mitur Klaudjo Kume të paditurës; 3. Caktimin e takimeve personale prindërore me fëmijën e mitur Klaudjo Kume sipas vlerësimit psikologjik; 4. Caktimin e pensionit ushqimor për fëmijën e mitur Klaudjo Kume në masën 5000 (pesë mijë) lekë; 5. Paditësja të marrë mbiemrin para martese Sula”* ka vendosur:

- 1. Pranimin e pjesshëm të kërkespadiës.*
- 2. Zgjidhjen e martesës midis paditësit Julian Kume dhe të paditurës Marsela Kume, duke marrë e paditura mbiemrin e saj para martese Sula.*
- 3. Në pikën 7 të dispozitivit të vendimit gjyqësor shpenzimet gjyqësore i lihen në ngarkim të paditurës në masën 50 %.**

Në Vendimin përfundimtar gjykata shpreh që shpenzimet gjyqësore janë në ngarkim të paditurës znj. Marsela Kume në masën 50 %.

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka likujduar për shërbimet e ofruara Av. Inesa Grazhdani me vlerë 40.000 lekë, dhe Eksperten Marinela Postoli me vlerë 40.000 lekë.

Për sa më sipër, në mbështetje të Nenit 30 të Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” si dhe Kodit të Proçedurës Civile, **ju lajmërojmë për kryerjen e ekzekutimit vullnetar brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit**, në zbatim të Vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë me nr. 41-2024-868 (253), datë 06.03.2024,

të shumës prej 40.000 lekë, të parapaguara nga ana jonë për shpërblim avokati dhe eksperti, ofruar për përfituesin e ndihmës juridike dytësore Falas z. Julian Kume.

**Shlyerja e ekzekutimit vullnetar të kryhet në llogarinë e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas me NIPT L11704452P.**

*Në rast se vendimi nuk ekzekutohet vullnetarisht, me kërkesë të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, shërbimi përmbarimor gjyqësor fillon procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm, sipas legjislacionit në fuqi.*

Nga njoftimi i bërë nga shërbimi postar ka rezultuar i pamundur kontakti me znj. Marsela Kume.

Në këto kushte referuar nenit 146 të Kodit të procedurës Administrative, kur njoftimi është i pamundur, në respektim të të drejtave ligjore, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas vendosi që njoftimi të bëhet nëpërmjet shpalljes publike në këndin e njoftimeve në Bashkinë Gjirokastrë, Lagjia Varosh, Rruga "18 Shtatori", si dhe në faqen Web të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

Ky njoftim duhet të qëndrojë jo me pak se 20 ditë.

Njoftimi quhet i bërë kur Bashkia Gjirokastrë depoziton në Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas një kopje të aktit bashkë me dokumentat që vërtetojnë shpalljen publike.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Ergys Qirici**

